

Një simbolike lëmoshë për të jetuar

E folme dhe e shkruame arbëreshe

Ca qerò prapa Papa shpalli një enciklike me përmbajtje shoqërore dhe ekonomike. E kish shkruar gjermanisht. Kish klënë përkthyer te gluhët më të rëndësishme. Por ngë kle përhapur sepse kish një problem: te përkthimi zyrtar, latinisht, ngë dihej si kish t'i pëkthenin disa terma porsanith lerë. Iu desh një javë konsultime të tërbuam ndër më të mëdhenjtë latinistë të planetit, për të zgledhur neologjizmat më të përshtatshëm e të plotë çë mënd të shprehnin qartë ata ndëltime.

Pyetja çë vetë bëhem ë' nëse kemi "arbëristë" në Arbëri në gjendje të kodifikojnë korrijen neologjizmesh e duhur për të kryer një funksion publik cili ë' administrata dhe ligja. Ngjera më sot, nga kur kle vënë mënjanë latinishtja nga institucionet shtetore, vetë latinishtja u bë burim gluhësor bashkë me greqishten e lashtë. Ajo korrije fjalësh-termash – dhe tjera – u bë qosmë të përbashkët njësuere të dijes, të gjellës së njerëzimit.

Film, hamburger, intëllixhensë, taktikë, strategji, marketing mund t'i arbërishtizosh por atò janë nanimë fjalët e jo tjera të dyshimta: - cipe, petull, kundërspiunazh, zgjuarsi, plan, kërkime shitjeje -. Prandaj ngë rri këtë problemi i "gluhës bashkëlidhore" arbëreshe.

Problemi rri më mirë te të ndryshmet ndotje degjeneruese për afërsi osmotike e ambientit dhe te më e madhja varfëri e së folmes së përditshme nanimë tek ankthi i fundit.

Ruajtja e gluhëvet të minoritetevet – bërë nga ligja 482/99 – ngë kryen plotësisht urdhërimin kushtetues, çë te neni 6 deklaron se ruan "minoritetet gluhësore" *tout court*. Sigurisht ngë janë 10 milionë eurosh burimet të duhura për të ruajtur 2 milionë vetash: 5 euro për frymë ngë janë ruajtje por dhuratë simbolike - **simbolike lëmoshë**. Qëndron ajo çë ka më rëndësi: **e drejta e të jetuarit si arbëresh – burim kulturor e gjinisë njerëzore**.

Varfëria e së folmes së përditshme, litire o arbëreshe çë do të jetë, tjetër ngë ë' veçse t'u dukurit t'u dëftuarit të papërshtatjes kolektive dhe vetjake ku ndodhen disa milionë njerëz të rritur. Atà ngë mënd të kenë më lidhje me të shkuamen e tyre nanimë e vdekur as me realitetin e sotëm nga i cili janë lënë mënjanë. Për shembull, të thuhet se sot duhet t'i drejtohem INPS-it "telematikisht" do të thetë të dënosh me veçimin e me dëshpërimin pikërisht milionë vetash. Edhë brënda organizatës së punës kemi drejtues – pa të duhurat proteza mendore – të pazotë të sintonizohen me teknologjitë organizative të reja, tue shkaktuar konflikte të vërtetë me vartësit më të ri, lundruet të zotë të qëroit.

Me më hollësi ngë ndëlgohet nga ana e shumë njerëzve si gluha e përkatësisë, ajo shpiake, ë' platforma themeluese e vëtës, çë ë' bashkëlidhore ose më mirë ë' bashkëlidhje. Mbi atë te një kontekst dygluhësor zhvillohen të rrënjosura aftësi logjike çë lejojnë t'u zgjeruarit ndaj tjera përvijimeve mendore të mundshme.

Për të përforcuar këtë, ca ditë prapa pash në televizion një intervistë e dhënë nga një kopile, pinjoll(pinok) i një familje shumë e qosme piemontese, çë pergjegjej me thjeshtësi dhe kthjelltësi të stërmadhe por me mprehtësi dhe me thellësi shpirti, çë ngë gjen te shumë bashkëkohës të saj, mbi të rëndësishme çështje me spikatje politike planetare. Prandaj ngë ë' i rastit zotërimi shprehës me pesë gluhë. Sigurisht ngë iu lipsën më të mirët mjeshtër.

Por më të mirët mjeshtër i ka edhe Arbëria. Arbëria ë' si një minierë famasmash në të cilën janë pak atà çë ulen të rrëmojnë. Atà çë e kanë bërë, kanë mbledhur rezultate të mëdhenj të mëdhenj dhe njohje të zhurmshme. Por janë vetëm monadhe, ngë janë të aftë të bashkohen te një rreth kulturor – makar vetëm telematik –, çë për t'u lipsurit i të cilit ngë mënd të dalë një leadership kulturore me autoritet dhe e besuashme, e përbashkët e pa interes vetjak, vend krahasimi e jo ndeshjeje të përhershme pa "grip"(skalasje) pozitiv.

Kur thuhet se është aq shumë puna çë ka të bëhet! Shqetësimi im rritës drejtohet ndaj mblakjes së pamëshirshmes të të ngarkuamit-amatorë. Ngë shoh – mënd të gabohej! – vargërinë e brezavet të reja. Ngë shoh një të lulezuar interesash, zhvillimesh, gjakimi. Për sa mënd të vlejë përvoja ime,

mënd vetëm të dëshmoj se çdo rraskapitje kushtuar për të mbajtur në gjellë nisma arbëreshe edhe shumëvjeçare pra më ka dhënë bukë, sepse më ka shërbyer te bota e punës prodhuese, te jeta.

Te një shoqëri nanimë e kushtuar punës së parregullt, ngë ë' sigurisht qërò i lirë që lipset. por ë' pikërisht nga ky qërò që duhet nxirrë fitim. Duhet u qosur me kulturë te papunësia e detyruar. Duhet investuar te dieja me ngulm, me metodë. Bota ndërrohet vazhdimisht, me shpejtësi. Duhet qëndruar mbi trenin e qëròit. Duhet e mbajtur veten për nxënës të përjetshëm për të mos u bërë hedhurinë e vjetër më parë se hera.

Cila mundësi më e mirë, prandaj, për t'u kushtuar gjëravet të Arbërisë, gluhës së vet. Sigurisht tue përdorur dhe plotësuar kompetencat teknologjike e veta por tue mbajtur parasysh edhe se më të stërgjyshoret njohje, mirë se ngë sfaqen, mbajnë gjithë e tërë të tyren vlerë ekzistenciale shpëtuese.

22.11.2010 Paolo